



Bordi
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 193, Datë 24.11.2017

MBI

**MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRKOHSHME PËR MEKANIZMIN
BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 98 dhe 100 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 5 të VKM nr. 244/2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; pikën 3.3 të VKM nr. 519/2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”; Vendimit të Bordit të ERE nr. 139, datë 15.08.2016 “Rregullat e Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”; si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për miratimin e draft- “Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike”,

Konstatoi se,

- ERE me Vendimin nr. 124, datë 16.08.2017, filloi procedurat për miratimin e “Rregullave të Përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”.
- ERE me shkresën nr. 100/33 Prot., datë 16.08.2017, publikoi për 3 ditë me rradhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të Bordit, duke filluar nga data 18 Gusht 2017. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.
- Po ashtu me shkresën nr. 560 Prot., datë 21.08.2017, ERE dërgoi “Rregullat e Përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: KESH sh.a., OSHEE sh.a., MEI, Autoriteti i Konkurrencës.
- KESH sh.a. me shkresën nr. 4473/1 Prot., datë 08.09.2017, ka paraqitur në ERE komentet mbi draft - “Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike”, të cilat nuk u pranuan nga ERE.
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 346/1 Prot., datë 20.09.2017, bëri me dije se ky akt nënligjor nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 19944/1 Prot., datë 21.09.2017, ka dhënë komentet e saj mbi draft - “Rregullat e Përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, të cilat kryesisht u pranuan.

- Me shkresën nr. 5039/1 Prot., datë 05.10.2017, OST sh.a. ka ridërguar draftin e përpunuar me sugjerimet e ERE, duke i marrë në konsideratë ato dhe reflektuar në draft Rregullat e Përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike, së bashku me disa ndryshime të tjera, të cilat OST sh.a. i ka gjykuar të nevojshme pas rishikimit të kësaj rregullore.
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka ofruar ndihmë teknike OST sh.a. në lidhje me hartimin e Rregullave të Përkohshme për Mekanizimin e Balancimit të Energjisë Elektrike.
- ERE organizoi një seancë dëgjimore, datë 07.11.2017 për të dëgjuar opinionin e palëve në lidhje me finalizimin e draft Rregullores. Palët në këtë seancë shprehën përgjithësisht dakortësinë mbi këtë draft rregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë “Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike (Rregullat e përkohshme për Mekanizmin Balancues bashkëlidhur)”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 Janar 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

Votimi i Antarëve të Bordit të ERE, për,

VENDIMIN

Nr. 193, Datë 24.11.2017

MBI

**MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË PËRKOHSHME PËR MEKANIZMIN
BALANCUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Antarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____